



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve **Ismail Zeneli, Bujar Ajeti, Adrian Cenaj (Dedja), Dedan Gjoni, Besmir Murati dhe Albert Prenga**”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtaret Erjon Çela, Erjon Bani dhe Bib Ndreca, me vendimin nr. **75**, datë **21.11.2025** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ismail Zeneli**, për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 283/a/1 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 13 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ismail Zeneli, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 5 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ismail Zeneli, për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 80 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 9 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ismail Zeneli, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 5 vjet burgim.
- Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, dënimin e të pandehurit Ismail Zeneli me një dënim të vetëm me 15 vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Ismail Zeneli me një dënim të vetëm përfundimtar prej 10 vjet burgim.
- Vuajtja e dënimit për të pandehurin Ismail Zeneli do të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Bujar Ajeti (Gremizi), për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 80 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 7 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Bujar Ajeti (Gremizi), për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 3 burgim.
 - Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Bujar Ajeti (Gremizi), për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, e parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal pasi në zbatim të nenit 388/1/a të K.Pr.Penale nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Bujar Ajeti (Gremizi), për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, e parashikuar nga neni 278/4 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 3 burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Bujar Ajeti (Gremizi), për kryerjen e veprës penale “*Përkrahja e autorit të krimit*”, e parashikuar nga neni 302/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 5 burgim.
 - Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, dënimin e të pandehurit Bujar Ajeti (Gremizi) me një dënim të vetëm me 9 vjet burgim.
 - Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Bujar Ajeti (Gremizi) me një dënim të vetëm përfundimtar prej 6 vjet burgim.
 - Vuajtja e dënimit për të pandehurin Bujar Ajeti (Gremizi) do të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Adrian Cenaj (Dedja), për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 80 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 6 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Adrian Cenaj (Dedja), për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 vjet burgim.
 - Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, dënimin e të pandehurit Adrian Cenaj (Dedja), me një dënim të vetëm me 6 vjet burgim.
 - Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Adrian Cenaj (Dedja), me një dënim të vetëm përfundimtar prej 4 vjet burgim.
 - Vuajtja e dënimit për të pandehurin Adrian Cenaj (Dedja), do të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.

4. Deklarimin fajtor **të të pandehurit Dedan Gjoni**, për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 80 - 25 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite ligjore dënimin e tij me 2 vjet burgim.
- Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Dedan Gjoni, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/1 i K.Penal pasi në zbatim të nenit 388/1/a të K.Pr.Penale nuk provoohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale.
 - Deklarimin fajtor **të të pandehurit Dedan Gjoni**, për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 283/a/1 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 12 vjet burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Dedan Gjoni, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Dedan Gjoni, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 vjet burgim.
 - Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, dënimin e të pandehurit Dedan Gjoni me një dënim të vetëm me 12 burgim.
 - Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Dedan Gjoni me një dënim të vetëm përfundimtar prej 8 burgim.
 - Vuajtja e dënimit për të pandehurin Dedan Gjoni do të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
5. Deklarimin fajtor **të të pandehurit Besmir Murtati**, për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 283/a/1 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 12 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Besmir Murtati, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, e parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 vjet burgim.
 - Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, dënimin e të pandehurit Besmir Murtati me një dënim të vetëm me 12 vjet burgim.
 - Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Besmir Murtati me një dënim të vetëm përfundimtar prej 8 vjet burgim.
 - Vuajtja e dënimit për të pandehurin Besmir Murtati do të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
6. Deklarimin fajtor **të të pandehurit Albert Prenga**, për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit

- të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 283/a/1 - 28/4 i Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal dënimin e tij me 12 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Albert Prenga për kryerjen e veprës penale “Grup i strukturuar kriminal”, e parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 3 vjet burgim.
 - Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, dënimin e të pandehurit Albert Prenga me një dënim të vetëm me 12 vjet burgim.
 - Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Albert Prenga me një dënim të vetëm përfundimtar prej 8 vjet burgim.
 - Vuajtja e dënimit për të pandehurin Albert Prenga do të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
7. Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal të pandehurit Bujar Ajeti, si më poshtë:
- 2(dy) telefona celular, të markës Iphone, ku njëri është i hapur me nr. IMEI **** dhe ****;
 - Një aparat telefonik i markës Samsung me nr. IMEI **** dhe nr. ****, pa kartë Sim;
 - Automjet me targë ****, t’i kthehen këtij të fundit.
8. Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal të pandehurit Dedan Gjoni si më poshtë:
- 1 (një) Aparat telefonik i markës SAMSUNG;
 - 1 (një) aparat telefonik i markës Iphone, t’i kthehen këtij të fundit.
9. Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal të pandehurit Adrian Cenaj,
- 1 (një) automjet i markës Mercedes Benz ngjyrë gri metalizato me portobagazh me targa ****;
 - 1(një) aparat celular me kapak ngjyrë gri Nokia Bisnes me tastierë në gjendje të fikur;
 - 1 (një) aparat celular Iphone 12 ngjyrë e zezë;
 - 1 (një) Aparat celular Iphone 12 Pro Max me ngjyrë të zezë, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.
10. Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal të pandehurit Bujar Ajeti:
- 1 (një) DVR me bar kod ****;
 - 1 (një) Pistoletë model Jericho 941 “Made in Israel”, kalibër 9x19mm me nr. **** me karikator me fishekë 9mm, gjithsej 15 fishekë;
 - 1 (një) dylbi të markës “Bushnell” me këllëf;
 - 1 (një) dylbi me mbishkrimin **** dhe **** e markës Pulsar;
 - 1 (një) dylbi me mbishkrimin **** dhe **** të markës Pulsar së bashku me këllëf;
 - 1 (një) këllëf pistoletë, plastic brezi;
 - 1 (një) telefon i markës Blackberry i fikur me kartë SIM nr.****;

- Dy thika dhe këllëf;
 - 1 (një) shurëse zhurme (silenciator) metalik me ngjyrë të zezë;
 - 1 (një) armë gjahu gjysëm automatike, e markës “Benelli” model SuperVinci me ngjyrë të zezë;
 - 1 (një) dylbi me ngjyrë të zezë e markës “Nikon” me mbishkrim ****.
 - Dy fotografi ku në njëren është shtetasi E.B dhe në foton tjetër është Bujar Ajeti (Germizi) bashkë me E.B, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.
- 11.** Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal të pandehurit Besmir Murtati:
- Llogaria bankare nr. **** me vlerë 77,998.5 euro të shtetasit M.M, në Bankën Kombëtare Tregëtare;
 - Aparat celular markes Iphone, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.
- 12.** Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal të pandehurit Dedan Gjoni:
- 1 (një) kuti plastike me ngjyrë gri, ****;
 - 1 (një) armë zjarri me nr. **** me mbishkrimin ****;
 - Dy krëhëra pistolete **** 14 (katërmbëdhjetë) fishekë 9 mm;
 - Një dokument me mbishkrimin “Autorizim për mbajtje armë zjarri në banesë” me nr. regjistri **** datë 12.09.2019 për armën model SigSaur me numër ****, gjithsej 9 (nëntë) fletë, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.
- 13.** Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale, një pasaportë në emër të shtetasit B.V.G, datëlindje **** me nr. ****, t’i kthehet shtetasit B.G.
- 14.** Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale, 1 (një) automjet të markës Range Rover Evoque me Nr.shasie **** me targë ****, bashkë çelësin dhe dokumentacionin në pronësi të shtetasit A.Ç, t’i kthehet shtetasit M.Ç.
- 15.** Shpenzimet procedurale gjatë fazës së hetimit si dhe shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të pandehurve në mënyrë solidare.
- 16.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 22.11.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar